



REPUBLIKA E SHQIPERISE



## **VENDIM**

***Nr. 150, Datë 31.10.2012***

**PËR**

### **FILLIMIN E PROCEDURAVE LIGJORE PER KONTRAKTIMIN E NJE KONSULENTI LIGJOR QE DO ASISTOJE ERE NE MOSMARREVESHJET E KRIJUARA ME SHOQERINE CEZ SHPERNDARJE SH.A,**

Në mbështetje të nenit 9, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Ligjit nr. 10 116, datë 23.4.2009 “Për miratimin e kontratës së shitjes së 76 për qind të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a.-së ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe ÇEZ a.s.-së”, Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 392, date 8.4.2009, “Per miratimin e Rregullores “Per marredheniet e avokatures se shtetit ne institucionet shteterore dhe entet publike, rolin e avokateve te shtetit ne gjykim, si dhe normat e posacme procedurale”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 31.10.2012, mbasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

#### **Vendosi:**

1. Të filloje procedurat ligjore per kontraktimin e nje zyre juridike me eksperience nderkombetare e cila te mbeshtese ERE me keshillimet e nevojshme juridike ne lidhje me mosmarreveshjet e krijuara me shoqerine CEZ Shperndarje sh.a.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes se Konsumatorit, te marre gjitha masat ligjore per realizimin e kesaj procedure.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Sokol RAMADANI**

**NE mungese, me porosi**

**Adriatik BEGO**